



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1916 / Prot.
3

Tiranë, më 23.01 2015

VENDIM

Nr. 07, datë 23/01 2015

Bazuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikat 3, 5/b të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, nenin 31/1/a/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nenet 93-95 të Kodit të Procedurës Administrative, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1916 Prot., datë 15.12.2014 me objekt, “Refuzim dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ndaj autoritetit publik/Shërbimit Informativ Shtetëror. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me pikën 1 dhe 2/b të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se Qendra “Res Publica” në datë 10.11.2014 ka paraqitur pranë Shërbimit Informativ Shtetëror kërkesën për informacion dhe kopje të dokumenteve zyrtare duke kërkuar “të dijë mbi numrin e personave të vendosur nën përgjim në periudhën 01.01.2014 – 31.10.2014 në Republikën e Shqipërisë”.

Shërbimi Informativ Shtetëror, nëpërmjet shkresës nr 33/1Prot., datë 19.11.2014, i është përgjigjur kërkuarit brenda afatit kohor në përputhje me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke refuzuar dhënien e informacionit me arsyetimin se, informacioni i kërkuar është i klasifikuar “sekret shtetëror”, bazuar në ligjin nr. 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9157 datë 04.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në nenin 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ka kërkuar Shërbimit Informativ Shtetëror që deri në datë 26.12.2014 të depozitojë parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Qendra “Res Publica”.

Në parashtrimet e dërguara Shërbimi Informativ Shtetëror ka argumentuar se është i përjashtuar nga detyrimi që kërkon publikimin e informacionit të klasifikuar, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar” i ndryshuar, i cili

shprehimisht përcakton se, “Shërbimi Informativ Kombëtar përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit.”

Përveç përcaktimit ligjor në ligjin e tij organik, Shërbimit Informativ Shtetëror argumenton se informacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion pasi i gjithë procesi i përgjimit në tërësi përbën “sekret shtetëror”. Për këtë referon nenin 16 “Kufizimet në përgjim”, të ligjit nr. 9157 datë 04.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike” i ndryshuar, në të cilin shprehimisht thuhet se, “2. Procesi i përgjimit, ne tërësi ose ne veçanti, përbën sekret shtetëror, shkelja e te cilit dënohet sipas legjislacionit penal ne fuqi.”

Sipas parashtrimeve, në përputhje me përcaktimet e nenit 20 të ligjit nr. 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” i ndryshuar, parashikohet se ruajtja e informacionit të klasifikuar bëhet sipas akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave. Në vendimin nr. 312 datë 16.03.2011 “Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” të Këshillit të Ministrave, parashikohet se, “Përkthimi, riprodhimi, fragmentizimi i një dokumenti dhe /ose një materiali të klasifikuar përmban të gjithë shenjëzimet e një informacioni të klasifikuar “sekret shtetëror” dhe trajtohet si i tillë”.

Lidhur me pretendimin në vijim të ankuesit, për moszbatimin e pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, (gjatë trajtimit të kërkesës) sipas së cilës “E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit...”, Shërbimi Informativ Shtetëror ka referuar si bazë ligjore, ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” i ndryshuar, me argumentin se, informacioni i kërkuar nuk përfshihet në procedurat e deklasifikimit sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, konkretisht në nenin 13 të tij. Sipas Shërbimi Informativ Shtetëror, afati i ruajtjes së klasifikimit të informacionit të kërkuar është 35 vjet dhe niveli i klasifikimit “Sekret”, përcaktuar në Urdhrin nr. 16-39/1, datë 08.03.2011 “Për listën e dokumenteve të klasifikuar “sekret shtetëror” në Shërbimin Informativ Shtetëror”.

Komisioneri, bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” zhvilloi më datë 19.01.2015, seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Në këtë seancë, pretendimet e palëve reflektuan të njëjtat kërkesa dhe shpjegime të dhëna në ankesa e parashtrime.

Pas shqyrtimit të ankesës, parashtrimeve, seancës dëgjimore, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, procesi i përgjimit në tërësi nga autoriteti përgjegjës është klasifikuar “sekret shtetëror” dhe si i tillë i nënshtrohet kufizimeve ligjore. Ndërsa, ankuesi kërkon një pjesë të të dhënave të përfshira në dokumentacion, Shërbimi Informativ Shtetëror shprehet për rishikimin e informacionit të klasifikuar për “listën e dokumenteve të klasifikuar sekret shtetëror”. Bazuar në pikën 5 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Shërbimi Informativ Shtetëror duhet të kishte përmbushur detyrimin për të nisur menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit për informacionin e kërkuar (pjesë e tërësisë së procesit të përgjimit) që gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror” duke njoftuar

kërkuesin për ndjekjen e kësaj procedure si dhe vendos shtyrje të afatit për dhënie të informacionit deri në 30 ditë pune.

Gjithashtu, nuk rezulton që nga Shërbimi Informativ Shtetëror të jetë kryer balanca për prevalimin e sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” i ndryshuar si dhe legjislacioni për kufizimin e të drejtës për informim me interesin publik konform ligjit për të drejtën e informimit.

Theksojmë se, e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 5/b të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe nenin 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1916 Prot., datë 15.12.2014, të ankuesit Qendra “Res Publica” ndaj Shërbimit Informativ Shtetëror.
2. Urdhërimin e Shërbimit Informativ Shtetëror, për fillimin menjëherë të procedurës së rishikimit të klasifikimit të dokumentacionit të kërkuar dhe njoftimin e ankuesit.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative, në përputhje me nenin 25 të ligjit për të drejtën e informimit.

Ky vendim u dha sot në datë 23.01.2015.

